

MUHARREM DEZHGIU

**YMER DISHNICA ATDHETAR DHE ANTIFASHIST
NË VITET E LUFTËS II BOTËRORE***

Pushtimi fashist i Shqipërisë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, vuri në provë ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve për rivendosjen e pavarësisë. Para kësaj prove historike shqiptarët shpalosën qëndrimet e tyre pavarësisht nga shkalla e formimit kulturor e arsimor, nga mosha, apo përkatësia e bindjeve politike.

Duhet thënë, që në fillim, se në krye të qëndresës antifashiste u dalluan mjaft intelektualë me formim të shëndoshë të ndërgjegjes kombëtare. Midis tyre bënte pjesë dhe intelektual i përgatitur në universitetet e Evropës Perëndimore, doktor Ymer Dishnica.

Njëqindvjetori i lindjes së tij, na jep mundësinë ta kujtojmë me respekt të thellë për misionin fisnik, që ai mori përsipër, në ato vite të vështira për shqiptarët.

Ishte veçse 30-vjeçar, kur mjeku i diplomuar, Ymer Dishnica, do të kthehej nga Franca në Atdhe. Formimi i tij solid profesional e intelektual dhe pagëzimi me ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore e orientuan “Doktorin” të jepte ndihmesën e tij të drejtpërdrejtë në lëvizjen antifashiste, në shërbim të atdheut të tij.

Që në Francë, duke qenë nën ndikimin e ideve komuniste, u pozicionua në politikë si antifashist. Në Shqipëri veprimtaria e tij si antifashist vazhdoi duke u inkuadruar në radhët e PKSh. Programi i kësaj të fundit për qëndresën kundër fashizmit ishte tërheqës për Dishnicën, ashtu siç ishte për mjaft elementë idealistë të asaj kohe.

Ymer Dishnica, si komunist idealist, u angazhua në Lëvizjen Nacionalçlirimtare Shqiptare me synimin e çlirimit të vendit dhe të rivendosjes së pavarësisë së tij. Në periudhën e luftës për çlirimin e vendit, si komunist, ai ushtroi dhe detyra udhëheqëse në organet kryesore të PKSH, me idenë se edhe programi i saj kishte këtë detyrë si qëllim të parë.

* Kumtesa është mbajtur në mbledhjen përkujtimore, të organizuar nga familja me rastin e 100-vjetorit të lindjes, në MKRS, 21 shkurt 2012.

Për Ymer Dishnicën, detyrë kryesore që duhej përmbushur ishte çlirimi i vendit. Ndaj dhe në veprimtarinë e tij, pati një vijë konstante qëndrimi, për të mobilizuar çdo aset njerëzor në shërbim të luftës për çlirimin e vendit.

Falë aftësive bindëse në punën propagandistike politike ai u dallua në punën me nacionalistët. Pikërisht, për këtë veprimtari të veçantë me nacionalistët Ymer Dishnicës, i kishin vënë nofkën “çlirimist”, në dallim nga komunistë të tjerë, të cilët nuk e ndanin çështjen e çlirimit nga ajo e marrjes së pushtetit.

Bindja dhe mendimet e tij, për domosdoshmërinë e bashkimit të gjithë shqiptarëve në luftë spikatën gjatë diskutimeve në mjaft mbledhje të forumeve të partisë por dhe të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Në Konferencën e Pezës (shtator 1942), si një ndër përfaqësuesit e PKSH, Ymer Dishnica sillte si argument të bashkimit të komunistëve me zogistët, faktin që rreziku nuk i vinte vendit nga një njeri, por nga fashizmi. Pra, ky rrezik i përbashkët i vinte në një emërues të njëjtë interesat e komunistëve e të zogistëve, të cilët formuan Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (të përkohshëm). Për krijimin e Frontit ai iu referua shembullit të krijimit të Frontit Popullor në Francë. Në këtë Konferencë Y. Dishnica e vuri theksin në detyrën imediate, në luftën për çlirim, duke u shprehur se, për të ardhmen “populli do të vendosi ç’ të dojë”¹. Me mendimin e Dishnicës u pajtua dhe Abaz Kupi, i cili iu referua bisedës së bërë me Mustafa Kaçaçin. Kupi ishte shprehur: “Unë kërkoj Shqipninë njëherë e jo Zogun. Në qoftë se do populli [për Zogun – M.D.] do të “vendoset”². Në këtë mënyrë ideja e bashkimit të shqiptarëve në luftë për çlirimin e vendit si detyrë e vetme për të gjithë forcat politike erdhi në mënyrë të natyrshme.

Y. Dishnica me fjalën e tij të matur, realiste dhe bindëse, spikaste duke dhënë mendime të pjekura e me mjaft peshë në situata të tilla të rëndësishme politike. Në pranverë të vitit 1943, kur në qendër të debateve të Konferencës së Parë të Vendit të PKSh, ishte shqetësimi për të shtrirë ndikimin e komunistëve në popull, Y. Dishnica shtronte nevojën e bashkëpunimit me nacionalistët.

¹ Arkivi Qendror i Shtetit, Arkivi i Partisë (më tej: AQSH/AP), Fondi (F.) 40, Viti (V.) 1942, Dosja (D.) 1, fl. 2, Procesverbal i Konferencës së Pezës, Diskutimi i Ymer Dishnicës, 17 shtator 1942.

² *Po aty*, Diskutim i Bazit të Canës (Abaz Kupit).

Referuar përvojës së gabuar sektare të punës së komunistëve në Dangëlli e në Korçë, Y. Dishnica tërhoqte vëmendjen “të ruhem nga ky majtizëm se do na shpjeri në pushkë me Ballin”³.

Njëherazi ai kritikoi qëndrimet euforike të disa komunistëve të cilët shpreheshin se, “influenca e jonë ishte absolute”, duke i konsideruar përçarëse këto koncepte e mendime.

Me idetë e qarta për bashkëpunim me të gjitha forcat antifashiste, sidomos me ballistët, Y. Dishnica krijoi një besim të domosdoshëm, për të qenë ndër figurat kryesore të delegacionit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare gjatë bisedimeve me forcat e Ballit Kombëtar, në verë 1943. Ishte edhe kontributi i tij që Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, në mbledhjen e 9 korrikut 1943, pranoi kërkesën për të arritur një marrëveshje politike e ushtarake bashkëpunimi me Ballin Kombëtar. Në zbatim të kësaj kërkesë u caktuan dhe anëtarët e delegacionit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, që do të merrnin pjesë në bisedime. Ymer Dishnica do të kryesonte delegacionin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar.

Në korrespondencën intensive që pati Dishnica me drejtues të PKSH, gjatë muajit korrik e gusht 1943, spikati më së miri vendosmëria e tij për të kapërcyer të gjitha pengesat e për të arritur në finalizimin e marrëveshjes, tashmë të njohur, me emrin Marrëveshja e Mukjes. Informacionet e sakta e të plota, që jepte në letrat e tij, mbi situatën në prag dhe gjatë bisedimeve, ishin mjaft optimiste për suksesin e bisedimeve e të arritjes së Marrëveshjes. Y. Dishnica, së bashku me anëtarët e tjerë të delegacionit të KPNÇ e nënshkruan Marrëveshjen e Mukjes me bindjen se ajo ishte në vazhden e traditave më të mira atdhedashëse të shqiptarëve⁴. Në ato çaste vendimtare për kombin, kalonin në plan të dytë interesat e pjesshme dhe viheshin në plan të parë interesat kombëtare. Me krijimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, u jetësua, në shkallën më të lartë, platforma e Konferencës së Pezës për bashkimin e shqiptarëve në shkallë kombëtare.

Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë ishte organi më i lartë i drejtimit të luftës, që do të koordinonte bashkëpunimin e dy forcave

³ *Po aty*, F.14, V.1943, D.10, Procesverbali i Konferencës së Parë të Vendit të PKSH, 17-21 mars 1943. Diskutim i Dr. Dishnicës.

⁴ *Po aty*, F.14, V.1943, D.21, fl.4-10, Letër e Shafingos (Y.Dishnicës) për Tarasin (E.Hoxha), 3 gusht 1943.

politike në Shqipëri. Kjo formë organizimi e bashkimi e shqiptarëve, nën drejtimin e një organi të përbashkët në kohë lufte, ishte një domosdoshmëri për arritjen e çlirimit kombëtar.

Edhe për çështjen e Kosovës, për të cilën diskutoi e vendosi Mbledhja e Mukjes, Y. Dishnica dhe delegatë të tjerë bashkoheshin në një pikë, se çështja e Kosovës si pjesë e çështjes kombëtare shqiptare, duhej të rihapej e të zgjidhej në fund të Luftës së Dytë Botërore. Ai, së bashku me M.Gjinishin, dallonte nga pjesa tjetër më fanatike partiake komuniste e cila e konsideronte tabù çështjen e Kosovës, se ajo i përkiste Jugosllavisë, kurse qëndrimin e nacionalistëve ndaj Kosovës e quanin qëndrim shovinist.

Për të gjitha zhvillimet e Mbledhjes së Mukjes, Y. Dishnica njoftoi Komitetin Qendror të PKSH, me anë të një letre drejtuar E. Hoxhës. Pritej që Marrëveshja të gjente miratimin e udhëheqjes së PKSH, por nuk ndodhi kështu. E. Hoxha, nën ndikimin e plotë të M. Popoviçit, nuk u besonte shpjegimeve e arsytetimeve të Y.Dishnicës për zhvillimin e bisedimeve në barazi të plotë⁵.

Në një mbledhje urgjente të drejtuesve kryesorë të PKSH në Vithkuq të Korçës, Marrëveshja e Mukjes u dënua si e papranueshme. Njëherazi, u dënuan në mungesë Y. Dishnica e M.Gjinishi, si përgjegjës për nënshkrimin e saj. Më 8 gusht 1943, Enver Hoxha me nënshkrimin "Shpati" njoftoi të gjitha organizmat vartëse të Partisë për të mos njohur vendimet e Marrëveshjes së Mukjes. Ai shprehej: "Ky trakt është në kundërshtim me vijën nacionalçlirimtare dhe disaprovet nga KQ i Partisë. Prandaj, në rast se nuk e keni shpërndarë çirreni dhe të mos flitet më..."⁶

Që nga ky çast filloi kalvari i vuajtjeve për Y.Dishnicën. Ai u ndodh në pozitë të dyfishtë. Jo vetëm të sillte argumentet për qëndrimin e drejtë e parimor që kishte mbajtur, por duhej të bënte kujdes për mënyrën e qëndrimit politik, për t'i shpëtuar asgjësimit fizik, pasi e njihte mirë situatën në udhëheqjen e partisë, dhe qëndrimin ndaj elementëve që kritikoheshin prej saj.

Në mënyrë të natyrshme, Y.Dishnica nuk mund ta pranonte lehtë denoncimin e Mukjes. Ai ishte i bindur se kishte luftuar mjaft për të

⁵ *Po aty*, fl.17-19, Letër e Tarasit dërguar Shafingos, 6 gusht 1943.

⁶ *Po aty*, F.14, V. 1943, D.11, fl.13, Qarkore e Komitetit Qendror të Partisë, firmuar nga Shpati, 8 gusht 1943.

fituar Partia dhe Lëvizja Nacionalçlirimtare, sepse ishte arritur një marrëveshje në interes të frontit të përbashkët të shqiptarëve.

Duke pohuar se “vendimi për të mos njohur Marrëveshjen e Mukjes qe një bombë për ne”, Y. Dishnica, me delikatesën e një intelektualit të mençur, sqaronte me durim se, “nuk duhet harruar se aty në vend (në Mbledhjen e Mukjes – M.D.) bëhet diagnoza më e mirë”. Në këtë mënyrë i tërhiqte vëmendjen E. Hoxhës se, “Të na kishit dëgjuar edhe neve para se të merrnit vendime aq të prera”⁷. Me këtë përgjigje të parë, ai donte të thoshte se vendimi për denoncimin e Marrëveshjes së Mukjes ishte i prerë, i ashpër, i njëanshëm dhe me pasoja të rënda.

Y. Dishnica, në përgjigjen e 14 gushtit 1943, i bënte një “apologji” të vërtetë Marrëveshjes së Mukjes, jo duke u nisur vetëm nga interesat e partisë që i përkiste, por duke u nisur nga interesat e luftës së popullit shqiptar. Duke sqaruar me durim të gjithë ata që nuk donin ta kuptonin se ç’ishte bashkimi, ai thoshte: “Shtroheshim në tryezë për bashkim e të mos pranohim as edhe caktimin e një Komiteti të përbashkët të përkohshëm, komitet në të vërtetë marrëveshjeje dhe koordinimi, atëherë ç’fuqi reale i jepnim parimit të bashkimit”. Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë nuk ishte gjë tjetër veçse një komitet koordinimi e marrëveshjeje “pa prekur aspak independencën e organizatave, të shtabeve e të çetave”⁸.

Megjithatë, në Konferencën e Labinotit (shtator 1943), ku u dënua zyrtarisht Marrëveshja e Mukjes, Y. Dishnica nuk mundi t’i mbronte pikëpamjet e tij, nuk mundi t’u rezistonte akuzave që iu bënë. Ai, së bashku me M. Gjinishin, u konformuan me vendimin e Partisë për dënimin e Marrëveshjes së Mukjes duke përsëritur në mënyrë afirmative të gjitha shprehjet që kishte përdorur E. Hoxha në raportin e Konferencës për dënimin e Marrëveshjes, ku shprehej “U zu puna për bishti. Krijohet Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë”⁹. Y. Dishnica, e kuptoi se PKSH po largohej nga platforma e bashkimit të të gjithë shqiptarëve.

Anulimi dhe dënimi i Marrëveshjes së Mukjes ishte dëshmi e një lufte të brendshme që zhvillohej në gjirin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, e cila zhvillohej midis asaj pjese të shëndoshë të

⁷ *Po aty*, F.14, V.1943, D.21, fl.23, Letër e Shafingos për Tarasin, 14 gusht 1943.

⁸ *Po aty*.

⁹ *Po aty*, F.41, V.1943, D.4, fl.28-56, Procesverbal i mbajtur në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare (4-9 shtator 1943).

udhëheqjes, që inicioi dhe realizoi Marrëveshjen (përfshirë këtu dhe anëtarët e delegacionit të KPN) dhe pjesës tjetër ekstremiste dhe fanatike partiake të udhëheqjes së KPN. Në një farë mënyre, kjo ndarje, ishte reflektimi i dy rrymave që ekzistonin në PKSh. Klani i E. Hoxhës, i cili mbështetej nga M.Popoviçi doli më i fuqishëm. Dënimi i Mukjes i dha goditje dhe dobësoi pozitën e nacionalistëve brenda Frontit Nacionalçlirimtar, ku bënin pjesë edhe ata komunistë të quajtur “çlirimistë”, si Y. Dishnica, M.Gjinishi etj.

Ideali i Y.Dishnicës, për të luftuar kundër pushtuesit në gjirin e PKSh, që nga ky çast, ishte tronditur dhe çdo ditë që kalonte do ta bindte se ai ishte një iluzion. Udhëheqja e partisë ishte shndërruar në një klikë terroriste, që po asgjësonte kundërshtarët, si brenda dhe jashtë saj, për të marrë e vetme pushtetin.

Vendimi i marrë në Vithkuq, në gusht 1943, mbetej në fuqi për t’u ekzekutuar. Në gusht të vitit 1944 u vra njeri nga anëtarët e delegacionit në Mukje, M. Gjinishi. Ndërsa, Y.Dishnica u spostua nga detyrat partiake, duke e lënë në funksione administrative, derisa e larguan nga Tirana për në Berat, duke e dënuar së fundi për agjitacion e propagandë.

Qëndrimi bashkëpunues i Y.Dishnicës me të gjitha forcat antifashiste shqiptare, gjatë Luftës II Botërore, përbënte vlerën më të madhe të tij si atdhetar e antifashist, ndonëse për këtë qëndrim u akuzua për butësi mikroborgjeze dhe oportuniste nga klika antikombëtare e Enver Hoxhës, e cila e ndoqi Y. Dishnicën gjatë gjithë jetës.

Vepra e tij e ndërgjegjshme në shërbim të vendit si intelektual e atdhetar antifashist, të imponon homazh e respekt në 100-vjetorin e lindjes.